d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

NGRITJA E SISTEMIT TË RAPORTIMIT PËR PRODHIMIN E NAFTËS BRUTO PËR SHOQËRINË ALBPETROL SH.A.

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Albpetrol sh.a. është shoqëria shtetërore e naftës në Shqipëri. Aktiviteti kryesor i shoqërisë është kërkimi dhe prodhimi i hidrokarbureve, i cili përfshin ciklin e plotë të punimeve sizmike, gjeologjike, mekanike, gjeofizike, kërkimin, nxjerrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

1.2. Historiku

Albpetrol sh.a. e themeluar më 6 Prill të vitit 1999, e cila trashëgoi të gjitha asetet dhe vendburimet e naftës në Shqipëri. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Patosit ndërsa shoqëria ushtron aktivitetin e saj dhe në qendrat e prodhimit në Fier, Ballsh, Kuçovë, Patos etj.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë “Albpetrol” SH.A është kërkimi dhe prodhimi i hidrokarbureve, i cili përfshin ciklin e plotë të punimeve sizmike, gjeologjike, mekanike, gjeofizike, kërkimin, nxjerrjen dhe shitjen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, “Albpetrol” SH.A është kompania shtetërore e ngarkuar me monitorimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure të lidhura me kompanitë koncesionare.

Në funksion të misionit të saj, si dhe një vendimarrje sa më efikase, kompania ka ngritur një mekanizëm raportimi të prodhimit të naftës, i cili fillon nga raportimi i sasisë së nxjerrë të fluidit nga pusët, deri në sasinë e naftës bruto që magazinohet dhe më pas shitet në magazinat fiskale. Aktualisht, ky proces kryhet nëpërmjet blloqeve prej letre dhe file-eve të excel-it, qasje kjo që është subjekt gabimeve njerëzore gjithashtu nuk siguron integritetin dhe gjendshmërinë e të dhënave.

1.3. Situata Aktuale në Sektor

Me përparimin e vazhdueshëm të informatizimit të proceseve të punës, përdorimin gjithnjë e më të gjerë të shërbimeve elektronike dhe zhvillimet në teknologjinë e informacionit, është bërë e domosdoshme që Albpetrol të kalojë në një menaxhim elektronik të informacionit.

Një ndër proceset më të rëndësishme për kompaninë mbetet raportimi i prodhimit të fluidit dhe naftës bruto gjatë gjithë ciklit, që nga nxjerrja në pusë deri në magazinat fiskale. Aktualisht, ky proces realizohet manualisht: të dhënat regjistrohen në formë fizike dhe më pas dërgohen si fotografi në sektorin përkatës. Shefi i sektorit mbledh të dhënat nga të gjitha pusët dhe i raporton ato në qendrën e prodhimit, e cila më pas i përpunon dhe i përcjell ato tek Drejtoria e Prodhimit në Albpetrol sha.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi dhe implementimi i një platforme software moderne, e cila do të menaxhojë në mënyrë efikase, të sigurt dhe të besueshme procesin e raportimit të prodhimit të fluidit dhe naftës bruto në të gjitha fazat, nga nxjerrja në pusët e prodhimit deri te magazinat fiskale.

Platforma do të ofrojë një sistem raportimi të centralizuar dhe të standardizuar, duke u bazuar në kuadrin ligjor dhe rregulloret aktuale. Ajo do të mundësojë gjithashtu një monitorim të vazhdueshëm

dhe të saktë të gjendjes dhe shitjeve të naftës bruto, duke rritur transparencën dhe efektivitetin e menaxhimit të informacionit.

2.2. Qëllimi

Qëllimet e zhvillimit të këtij projekti janë:

1. Krijimi i një sistemi të unifikuar i bazuar në web, i cili do të mundësojë digjitalizimin e procesit të raportimit të indikatorve të prodhimit të naftës bruto gjatë gjithë ciklit;
2. Ndertimin e modulit të raportimit, i cili do të ofrojë raporte të paracaktuara, duke filluar nga baza në nivel pusi, gupesh apo rrotash, sektoresh vendburimesh, për të perfunduar në nivel QPN, këto raporte sipas kërkesës si dhe dashboard-e për nivelin drejtues duke ofruar një pamje më të saktë të efikasitetit dhe prodhimit të naftës bruto.
3. Implementimin/konfigurimin e platformës në serverat e Albpetrol Sh.A;
4. Mirëmbajtja e platformës për një periudhë 3 vjeçare;

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

(“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), duhet të realizojë:

- Zhvillimi, instalimi dhe integrimi i software sipas moduleve dhe nënsistemeve si më poshtë vijon:
 - Platforma e raportimit;
 - Profilet e përdoruesve;
 - Modulin e raportimit;
 - Konfigurimet e nevojshme për ndërveprimin me sisteme të tjera;
- Dokumentimi;
- Trajnime për përdoruesit;
- Mirëmbajtje;

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Disa nga supozimet e projektit janë:

- Vënia në dispozicion burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme për implementimin e sistemit;
- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti;
- Kontraktorit do t’i vihet në dispozicion çdo informacion që ka lidhje me proceset e punës aktuale;
- Autoriteti do të caktojë një mbikëqyrës që do të jetë përgjegjës për problemet e koordinimit dhe bashkëpunimit të përditshëm me Kontraktorin;
- Bashkëpunim i plotë i aktorëve;
- Bashkëpunimi i plotë i drejtorive përgjegjëse të këtij procesi;
- Analiza e saktë e proceseve të ndryshme, përfshirë këtu:
 - Proceset e raportimit;
 - Procesi i raportimit 3,6 dhe 9 mujore nga autoriteti;
 - Proceset e raportimeve vjetore;

- Kontraktorit do ti vihet në dispozicion listën e plotë e të gjithë puseve, grupeve, sektorve dhe vendburimeve;
- Listën e punojësit të cilët do të përdorin sistemin nga ana e Autoritetit dhe rolin e tyre;
- Listën e plotë të raporteve të cilat duhet të digjitalizohen në sistem me të gjithë specifikimet respektive;
- Interpretimi i saktë dhe fleksibiliteti i proceseve aktuale të punës së autoritetit kontraktues;
- Analizimi i saktë i kërkesave funksionale të paraqitura nga punojësit operacional;

3.2. Rrisqet

Disa nga risqet që mund të ndikojnë në mbarëvatjen e projektit janë:

- Analiza dhe projektimi i gabuar i sistemit;
- Dokumentimi jo i mirë i sistemit;
- Mospërbushja e plotë e kërkesave funksionale dhe teknike;
- Eksperienca e punojësit në projekt nga autoriteti kontraktor;
- Koha e implementimit, mos dorëzimi në kohë i projektit;
- Mungesa e bashkëpunimit midis aktorëve kyç dhe grupeve të interesit;
- Analiza jo e saktë e të dhënave ekzistuese;
- Analizimi jo i saktë i kërkesave funksionale të paraqitura nga punojësit e autoritetit;
- Mospërfshirja e të gjithë aktorëve;
- Mospërputhja e rezultateve të projektit me pritshmëritë, të cilat mund të jenë tepër të larta ose të përcaktuara në mënyrë tepër të përgjithshme;
- Mungesë bashkëpunimi mes sektorëve të përfshirë në proces;
- Mungesë komunikimi mes palëve gjatë ekzekutimit të projektit.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Ky projekt bazohet në aktet ligjore si në vijim:

Ligjin Nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”.

- Ligjin Nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
- Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”
- Vendim Nr. 734, datë 28.8.2013 “Për krijimin e sistemit unik të regjistrimit, autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesve në marrjen e shërbimeve publike nga sistemet elektronike.”
- Vendim Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 945, Datë 02.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, të ndryshuar.

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Për të mbledhur, analizuar dhe gjeneruar raportet e nevojshme të të dhënave, Albpetrol sh.a, do të pajiset me një platforme web në zotërim të plotë nga kompania.

(“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), duhet të realizojë detyrat sipas kërkesave të përshkruara dhe detyrimeve të kontratës. (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), në bashkëpunim me Autoritetin

Kontraktor, duhet të realizojë analizimin e dokumentacioneve, infrastrukturës, njohjen me kuadrin rregullator e bazën ligjore si dhe proceset e punës së Albpetrol.

Pas përfundimit të kësaj faze paraprake, (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), duhet të fillojë menjëherë zhvillimin e platformës dhe moduleve përkatëse. Në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor, (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), do të integrojë dhe krijojë përdoruesit në platformën e re dhe trajnimin e punojësve të Albpetrol, që do të përdorë këtë sistem.

Në fazën përfundimtare, (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), do të implementojë sistemin në serverat e Albpetrol sh.a me te gjithë elementet e sigurise . Ne perfundim te kontrates sistemi do te jete prone e Albpetrol sh.a dhe te dhenat te akseson pa patur nevojën e licensimeve ekstra.

Ne te ardhmen te jete mundesia qe sistemi te marre update dhe funksionalitete te reja.

4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Projekti do të mbuloj këto zona (me mundesi shtimi apo reduktimi te zonave) pikat në të cilën kompania operon perfshirë këtu vendodhjet gjeografike të mëposhtme:

- Fier
- Zharrëz
- Patos
- Kucovë
- Ballsh
- Cakran
- Visokë
- Vlorë
- Vllahinë
- Usojë
- Gorisht
- Kocul

4.1.3. Grupet e synuara

Ky projekt synon grupet e poshtë-përmendura:

- Albpetrol Sh.A;
- Qendra e Prodhimit të Naftës (QPN) Fier;
- Qendra e Prodhimit të Naftës (QPN) Kuçovë;
- Qendra e Prodhimit të Naftës (QPN) Gorishtë;
- Qendra e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit (QASHNG);
- Drejtoria e Prodhimit;
- Drejtoria e Gjeologjisë.

4.1.4. Siguria e sistemit

Sistemi duhet të jetë i qëndrueshëm, i besueshëm dhe të ofrojë në çdo kohë kontroll të integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit për të garantuar sigurinë nga ndërhyrjet e paautorizuara. Sistemi duhet të përdorë mekanizma autentifikimi modernë dhe të sigurt.

Sistemi duhet të ofrojë profile dhe role me të drejta (lexim, shkrim, kërkim, printim, eksportim etj.) të përcaktuara në nivel moduli dhe në të dhënat që mund të aksesojnë sipas profileve. Më specifikisht sistemi duhet të mundësojë:

- Administrim dhe konfigurim e sistemit - Sistemi duhet të sigurojë aftësi të menaxhimit të përdoruesit për krijimin dhe përditësimin e profilit të përdoruesit;
- Menaxhimi i roleve - Sistemi duhet të lejojë caktimin e një ose më shumë roleve specifike për përdoruesit;
- Menaxhimi i përdoruesve - Sistemi duhet të lejojë aprovimin, bllokimin dhe zhbllokimin e një llogarie specifike të përdoruesit;
- Auditim i përdoruesve - Sistemi duhet të ruajë historinë e veprimeve (logeve) të përdoruesit në sistem;
- Administrimi i fjalëkalimeve - Sistemi duhet të ofrojë enkriptimin e fjalëkalimeve;
- Komunikim i sigurtë - Sistemi duhet të mbështesë HTTPS/SSL;
- Sistemi duhet të ruajë gjurmë “timestamp” të login/logout;
- Panel për korrigjimin e gabimeve në hedhjen e të dhënave ose identifikimin e veprimeve të kryera në mënyrë të gabuar nga përdoruesit. Për këto veprime duhen ruajtur gjurmë/loge dhe koment tekst për veprimin e kërkuar.

Grupet e përdoruesve duhet të jenë si me poshtë:

- Administratorët e sistemit (në platformën web);
- Analisti (në platformën web);
- Raportuesi (në platformën web);

Sistemi duhet të ofrojë këto nivele të përdoruesve:

- Administratori - Niveli më i lartë i aksesit i cili është në përdorim vetëm nga specialisti i IT, ku menaxhon përdoruesit e tjerë, nxjerr raporte auditimi mbi aktivitetin e përdoruesve në sistem.
- Analisti – Ky nivel është për përdorim nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë dhe do të përdoret për analizimin e të dhënave të raportuara nga operatorët, gjenerimin e raporteve të ndryshme dhe eksportin e të dhënave.
- Raportuesi - Ky nivel aksesit do të përdoret nga Qendrat e Prodhimit të Naftës QPN, Qendra e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit QASHNG dhe operatorët e sektoreve perkates që do të mundësojë raportimin digjital të indikatorëve ndryshëm të prodhimit.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
☐ D0	☐ I0	☐ K0	
☐ D1	☐ I1	☒ K1	☐ U
☐ D2	☐ I2	☐ K2	☐ M
☒ D3	☒ I3		☒ L

Për të arritur nivelin e mësipërm të sigurisë, sistemi duhet të ketë këto specifikime të sigurisë:

Sistem autentifikimi dhe autorizimi

- Platforma duhet të sigurojë qasje vetëm për personat me kredenciale të kenë akses në të. Kjo duhet të sigurohet nëpërmjet një sistemi identifikimi ku përdoruesit duhet të vendosin emrin dhe fjalëkalimin për të patur qasje në sistem.
- Sistemi i autorizimit do mundësojë personat e identifikuar në sistem, të marrin rolin përkatës dhe të kenë akses në funksionalitete dhe të dhëna sipas këtij roli.

Sistem enkriptimi

- Enkriptim i të dhënave në trasmetim – Sistemi duhet të sigurojë që të dhënat janë të enkriptuara në çdo fazë trasmetimi, midis komponentëve si dhe nga përdoruesi fundor deri në databazë.
- Sigurimi i password-eve – Sistemi duhet të sigurojë që fjalëkalimet nuk ruhen në formë të pa-enkriptuar gjatë trasmetimit dhe në bazën e të dhënave

Sistemi i logeve

- Platforma duhet të mundësojë administratorët të identifikojnë veprimet e ndryshme që janë kryer në sistem nëpërmjet logeve. Loget duhet të kenë këtë set minimal të dhënash:
 - Koha e veprimit
 - Përdoruesi
 - Moduli
 - Veprimi
 - Modifikimi

Sistemi duhet të mundësojë log-e në databazë në mënyrë që të identifikojë çdo modifikim të dhënash që mund të bëhen jashtë platformës.

Frontend

Frontend duhet të suportoje standartet web të programimit CSS 3, HTML 5, dhe të jetë kompatibel me të gjithë shfletuesit (browsers). Front end duhet të jetë në gjendje të marrë të dhëna nga backend duke konsumuar webserviset. Sistemi front-end duhet të ndërtojë funksionalitetet e tij si komponente të cilat të kenë mundësi të riperdoren në çdo modul të sistemit. Sistemi frontend duhet të ndërtohet i tillë që të jetë totalisht i pavarur nga backend dhe të jetë funksional pa qenë nevoja e nderhyrjeve të metejshme nëse teknologjia e sistemit backend ndryshon. Sistemi duhet të shfaqë qartë përdoruesve errort dhe mesazhet e suksesit.

Backend

Backend duhet të ndërtohet në një gjuhë programimi e cila suporton arkitekturën MVC. Të gjithë modulet e sistemit duhet të konceptohen si mikroservise dhe të dergojnë të dhëna tek Frontend. Backend duhet të mbrojë web-serviset nga përdorimi i pautorizuar duke ruajtur të dhënat sensitive. Backend duhet të suportoje nderveprimin me databazat RDBMS.

Databaza

Databaza duhet të jetë e llojit RDBMS dhe të jetë kompatibel me teknologjinë që do të përdoret për sistemin e backend. Duhet të jetë në gjendje të ruajë logs për të gjithë veprimet që ndodhin në databazë.

Kodi burim

Kodi burimi nderfaqes dhe jo praktikave apo te dhenave, duhet te ruhet ne platformen git (Gitlab, Github ose ekuivalente). Kodi burim duhet te kete dy ndarje kryesore, main dhe development. Ku main do te perdoret per te mbajtur kodin i cili eshte ne sistemin live dhe development do te perdoret per te mbajtur kodin i cili eshte ne sistemin test. Teknologjia git duhet te beje te mundur qe gjate hedhjes se funksionaliteteve te reja ne kodin burim te beje kontrollet e nevojshme dhe teste automatike te kodit burim per te garantuar funksionalitetin e sakte te sistemit. Cdo funksionalitet i sistemit duhet te ndertohet ne nje dege (branch) te vecante dhe te jete kollaj i kthyeshem nese ndonje ndonje problematike e cila pengon funksionalitetin e sistemit.

4.2. Detyrat specifike

Projekti, do ti nënshtrohet 5 (pesë) fazave që paraqiten si mëposhtë:

Faza I: Mbledhja dhe analizimi i kërkesave dhe miratimi i proceseve

Në këtë fazë do të bëhen këto detyra:

- Analizimi dhe konfirmimi i bazës ligjore dhe rregulloreve të kompanisë;
- Analiza e kërkesave funksionale të sistemit (në bashkëpunim me punojësit e Albpetrol sh.a);
- Rishikimi dhe konfirmimi i proceseve të raportimit;
- Përcaktimi i formave të raportimit dhe workflow-et përkatëse;
- Përcaktimi i formës së dashboard-eve për nivelin drejtues;

Faza II: Zhvillimi i platformës

Në këtë fazë, (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”) duhet të zhvillojë platformën, modulet dhe funksionalitetet e mëposhtëme:

- Design i bazës së të dhënave;
- Zhvillimi i backend-it të platformës;
- Zhvillimi i modulit të raportimit;
- Zhvillimi i dashbord-eve të ndryshëm;
- Zhvillimi i ndërfaqes web të platformës;
- Zhvillimi e aplikacioneve mobile (IOS dhe Android).

Faza III: Testimi dhe Trajnimi

Testimet do të bëhen për të verifikuar funksionalitetin e sistemit, për qëndrueshmeri, eficientë, performancë, debug, etj.

- Testimi i sistemit, dokumentimi i rezultateve të tij;
- Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre (nëse ka);
- Trajnimi i përdoruesve.

Faza IV: Marrja ne dorezim e sistemit

Pasi të gjithë modulet e sistemit të jenë testuar dhe certifikuar nga Operatori Ekonomik, do të bëhet marrja në dorëzim e sistemit. Në marrjen në dorëzim do të përfshihen:

- Kodi burim;
- Sistemi dhe të gjithë komponentët e tjerë software të implementuara;
- Dokumentimi i konfigurimeve përkatëse.

FAZA V: Mirëmbajtja

Mirëmbajtje e sistemit të përmirësuar do të jetë për një periudhë 3 vjeçare. Në përfundim të kontratës sistemi do të jetë prone e Albpetrol sha dhe të dhenat të akseson pa patur nevojën e licensave.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Platforma do të instalohet në serverat e Autoritetit Kontraktues.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës ose data e përcaktuar në kontratë dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 6 muaj nisur nga kjo datë dhe 3 vjet mirëmbajtja nga momenti i marrjes në dorëzim.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip në origjinal dhe 3 kopje:

- **Raporti Fillestar** duhet të përmbajë sygjerime të funksionaliteteve shtese bazuar në informacionin që është marrë gjatë takimeve me përfaqësues të Albpetrol sh.a. Keto funksionalitete nëse ka do të listohen në këtë raport fillestar dhe do të dërgohen Grupit për marrjen në dorëzim jo më vonë se 7 ditë nga data e zhvillimit të takimit. Grupi për marrjen në dorëzim duhet të bëjë aprovimin e raportit.
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të përbëhet prej të paktën 15 faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset)....]. Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 ditë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 5 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raport. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raportet e përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet komisionit të marrjes në dorëzim të projektit të caktuar nga Albpetrol sha. Komisionit të marrjes në dorëzim të projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Sistemi duhet të jetë në gjendje të ekspozojë të dhëna në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. Metoda e preferuar për ndërveprimin me sistemin do jetë duke përdorur API-te (Application Programming Interface). Gjithashtu sistemi duhet të mund të presë të dhëna të sistemeve të tjera elektronike në të ardhmen.

Disa prej sistemeve ekzistuese në Albpetrol, për të cilat sistemi të ofrojë mundësinë e ndërveprimit janë:

- Active Directory (për menaxhimin e përdoruesve)
- Sisteme të tjera që mund të kërkojnë nga Albpetrol Sh.a.

8. GARANCIA

Në këtë projekt, nuk parashikohen furnizim i pajisjeve hardware.

9. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë për një periudhë 3 vjecare, në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

9.1. Shërbimet e Mirëmbajtjes

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/përfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “ Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

- (ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Autoritetit Kontraktor/Përfituesit brenda intervalit kohor prej 5 orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t'i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë

procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Të garantohet funksionimi i sistemit 24 orë x 7 ditë të javës, remote ose onsite kur lind nevoja.

Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.

Palët e përfshira duhet të krijojnë një axhendë periodike kontrollësh 3 (tre) mujore, si më poshtë:

- Kontroll i statistikave të hapësirave server/storage (Hapësira e përdorimit të HDD-ve, etj);
- Kontroll i statistikave për sistemin;
- Të kryejë mirëmbajtje proaktive (mirëmbajtje parandaluese dhe parashikuese për makinat dhe pajisjet);
- Kontroll i funksionaliteteve të sistemit;

9.2. Kategoria e incidenteve

Kategoria A(Kritik/i Lartë)	Kategoria B (I Mesëm)	Kategori C (I Ulët)
Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare		
Mos funksionimi i funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime finaciare të mëdha për përdoruesit ose rrezikon shumë aktivitetin ekonomik të përdoruesve	Mos funksionimi i funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime finaciare të konsiderushme për përdoruesit ose rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik të përdoruesve	Mos funksionimi i funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime finaciare minimale për përdoruesit ose rrezikon në mënyrë minimal aktivitetin ekonomik të përdoruesve
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesë të punës së tyre	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Zgjidhje alternative e përkohshme[Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2.		
Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.

Koha e përgjigjes		
10 min. për të kthyer përgjigje Në vend brenda 5 ore.	30 min.për të kthyer përgjigje Në vend brenda 8 orëve	60 min.për të kthyer përgjigje Në vend brenda 24 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimet të zgjidhjes është 5 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimet të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimet të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

10.PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Ndërtimi i sistemit të raportimit - Design i bazës së të dhënave; - Zhvillimi i backend-it të platformës; - Zhvillimi i dashbord-eve të ndryshëm; - Zhvillimi i ndërfaqes web të platformës;	Set	1		
2.	Ndërtimi i modulit të raportimit	Cope	1		
3.	Ndërtimi i aplikacionit mobile (IOS dhe Android)	Cope	2		
4.	Trajnimi i personelit për sistemin e ri (jo më shumë se 20 persona për klasë)	Klasa	5		
5.	Mirëmbajtje dhe support	Vite	3		
TOTALI PA TVSH (LEKË)					

11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7		M42
1	Faza Përgatitore për sistemin software	x								
2	Faza e zhvillimit të sistemit software	x	x	x						
3	Faza e integritimit dhe testimit të sistemit software			x	x	x	x			
4	Trajnimi i përdoruesve					x	x			
5	Marrja në dorëzim						x			
6	Fillimi i procesit të mirëmbajtjes							x	x	x

12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe dokumentacionin teknik (mënyrën e konfigurimi të sistemit, skica, etj.) do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues. Sistemi do të dorëzohet i shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar, së bashku me setin e dokumentacionit teknik që përfshin dokumentacionin teknik të moduleve në veçanti dhe dokumentin teknik në tërësi.

13.KËRKESAT FUNKSIONALE

13.1. Struktura dhe rrjedha e informacionit

Sistemi i raportimit përfshinë një pjesë të madhe të struktures së Albpetrol sh.a, dhe si pasojë është e rendësishme të kuptohet rrjedha e informacionit dhe roli që kanë strukturat e ndryshme të Albpetrol sh.a.Më poshtë, bazuar në rrjedhën e fluidit, do të përshkruajmë çekim cdo pikë në të cilën raportohet sipas fazave ku fluidi kalon si dhe rolet e strukturave përkatëse.

Struktura naftë nxjerrëse e Albpetrol është e organizuar si më poshtë:

Qendrat e Prodhimit të Naftës (QPN): Albpetrol sh.a, bazuar në vendburimet e naftës, operon 3 (tre) qendra që janë: (1) QPN Fier; (2) QPN Kuçovë dhe (3) QPN Gorisht. Çdo qendër ka pikat e dekantimit, të cilat përpunojnë naftën e vendburimeve që administrohen nga kjo qendër. Për efekt administrimi dhe gjeografie, Qendrat janë të ndara në sektor, ndërsa sektorët të ndarë në grupe. Çdo grupe është i përbërë nga disa puse. Albpetrol sh.a dallon dy tipe pusesh (1) ata me depo dhe (2) ata pa depo. Pjesa më e madhe e pusëve në Albpetrol sh.a janë të llojit të dytë. Nafta e nxjerr nga këta puse mblidhet në depon e grupit, e cila më pas e transporton atë në pikat e dekantimit. Dekantimi është procesi në të cilën përpunohet fluidi për të dhënë naftën brut, e cila më pas shitet nga kompania. Dekantimi bëhet në nivel qendre dhe çdo gjendër mund të ketë një ose më shumë pika dekantimi. Çdo


qendër raporton të dhëna mbi procesin në nivel grupi dhe sektori. Këto të dhëna mbledhen dhe përpunohen nga specialistët e qendrës dhe me pas raportohen ne administratën e Albpetrol sh.a.

Qendra e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit (QASHNG) është një ndërmarrje e cila magazinon dhe administron produktin e gatshëm për shitje të prodhuar nga tre qendrat e prodhimit. Kjo qendër është përgjegjëse për procesin e depozitimit të naftës në magazinat fiskale si dhe shitjen e saj. Dallojmë dy mënyra të transportit të naftës në QASHNG që janë (1) nëpërmjet tubacioneve nga pika e dekantimit dhe (2) nëpërmjet transporti me autobote. Qendra raporton në mënyre të rregullt sasinë e naftës të shitur në Drejtorinë e Prodhimit në Albpetrol.

Drejtoria e Prodhimit është përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e të gjitha raportimeve që vijnë nga qendrat e prodhimit si dhe nga qendra e shitjes. Specialistët e saj gjenerojnë raporte javore dhe mujore, duke bërë dhe korrigjimet e nevojshme për prodhimin e naftës. Gjithashtu, bëjnë verifikime në terren dhe gjenerohet raporti mujor i prodhimit si dhe raportet e projeksioneve të prodhimit.

Më poshtë do të gjeni një skemë të strukturës dhe ciklit në të cilën kalon nafta e nxjerë nga sektorët e prodhimit.

Blokskema e mëposhtme ilustron ciklin në të cilin kalon fluidi gjatë gjithë procesit duke përfshirë nxjerrjen deri te magazinimi në magazinat fiskale të QASHNG.



13.1.1. Procesi i raportimit

Më poshtë do të specifikojmë të gjitha hallkat në të cilën kalon procesi i mbledhjes së të dhënave në funksion të analizës dhe gjenerimit të raporteve që përdoren nga Albpetrol sh.a.

Pusi – Të gjitha të dhënat për prodhimin e fluidit mblidhen në nivel pusi. Nga mënyra e operimit të puseve dallojmë dy lloje pusesh (1) Puse Ciklike dhe (2) Puse jo ciklik. Për cdo pus, specialistët e Albpetrol sh.a raportojnë orët e punës së pusit dhe bazuar në koeficientin e prodhimit, përlogaritet dhe sasia e fluidit e prodhuar nga pusi.

Grupi – Është hallka e parë ku specialistët raportojnë. Në nivel ditor, përgjegjësi i grupit raporton orët e punës së cdo pusi të cilat i kalojnë më pas sektorit. Në varësi të mënyrës së mbledhjes së fluidit (me depo grupi ose depo pusi) del sasia e prodhuar në nivel grupi, por granulariteti i raportimit është gjithmonë në nivel pusi.

Sektori – në këtë fazë, specialistët mbledhin dhe përpunojnë informacionin e ardhur në nivel ditor nga grupet dhe gjenerojnë raportet e prodhimit të fluidit në nivel sektori, të cilat më pas i kalojnë specialistëve të qendrës respektive. Në këtë fazë, bëhen analiza dhe korrigjimet e para të prodhimit nga specialistët e prodhimit të cilët korrigjojnë prodhimin në nivel pusi. Frekuenca e raportimit të sektorit është 12 dhe 24 orësh.


Dekantimi – Në këtë fazë, raportohet sasia fluidit që është transportuar (1) nëpërmjet tubacioneve dhe (2) nëpërmjet transportit me autobot, dhe sasia e naftës bruto të prodhuar pas procesit. Këto të dhëna raportohen bazuar në frekuencën e procesit të dekantimit dhe nuk kanë një frekuencë të përcaktuar. Specialistët e QASHNG raportojnë të dhënat (1) sasin e fluidit hyrës në proces, (2) sasin e naftës bruto të përfutur dhe (3) sasin e elementëve të tjerë [ujë, rërë, etj...] të përfutur nga procesi. Këto të dhëna raportohen në Drejtorinë e Prodhimit të Albpetrol.

QASHNG– Kjo qendër, raporton në Drejtorinë e Prodhimit të Albpetrol të dhëna si (1) sasin e naftës bruto që është depozituar në magazinën fiskale dhe (2) sasin e naftës bruto të shitur të operatorët privatë (3) sasinë e hyrë nga qendrat e prodhimit. Këto të dhëna raportohen bazuar në frekuencën e transportimit dhe shitjes së naftës dhe nuk kanë një periodicitet të përcaktuar.

QPN – Qendrat e Prodhimit raportojnë në nivel ditor në Drejtorinë e Prodhimit dhe në Drejtorinë e Gjeologjisë të Albpetrol sh.a të dhënat mbi sasin e fluidit të nxjerrë. Këto të dhëna janë të organizuara në nivel (1) Pusi, (2) Grupi dhe (3) Sektori duke dhënë një panoramë të saktë të efikasitetit të secilës zone që është nën administrim nga këto qendra.

Drejtoria e Prodhimit të Albpetrol – Drejtoria e Prodhimit mbledh dhe përpunon të gjitha raportimet të ardhura nga (1) Qendrat e Prodhimit dhe (2) QASHNG dhe gjeneron raportet e ndryshme përfshirë këtu (1) Raporti i prodhimit të fluidit, (2) Raporti i realizimit ditor (në ton) të prodhimit të naftës bruto, (3) Raporti i Shitjeve, (4) Raporti i humbjeve, (5) Raporti i gjëndjes së naftës bruto në nivel Grupi/Sektori/Vendburimi, (6) etj ... Gjithashtu, specialistet e Drejtorisë së Prodhimit, në bashkëpunim me specialistët e Qendrës, bëjnë rakordimet dhe korrigjimet e nevojshme bazuar në (1) procesin e analizave që bëhen në dekantim dhe (2) rakordimi i orëve të punës dhe koeficientët të prodhimit të puseve. Këto korrigjime kryehen në nivel mujor për të gjeneruar raportet përfundimtare të prodhimit dhe shitjeve.

Diagrama e mëposhtme ilustron procesin e raportimit të të dhënave në Albpetrol.



13.2. Funksionalitete

Në këtë seksion do të përshkruajmë modulet dhe funksionalitetet respektive të cilat duhet të këtë platforma.

Sistemi do te ketë keto komponentë dhe module:

- Aplaioni web:
 - Moduli i administrimit;
 - Moduli i raportimit;
 - Moduli i analizës;
 - Moduli i dashboar-eve;
- Platforma mobile

➤ Aplikacioi Web

Për secilin modul te aplikacionit web, janë specifikuar funksionalitetet e mëposhtme:

Moduli i administrimit	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Hyrja në sistem	Sistemi duhet të lejojë vetëm përdoruesit e autorizuar të aksesojnë sistemin nëpërmjet emrit dhe fjalëkalimit të personalizuar.

Manaxhimi i përdoruesve	Sistemi duhet të mundësojë administratorët të manaxhojnë përdoruesit e sistemit përfshirë këtu (Shtim, Përditësim, Fshirje).
Manaxhimi i të drejtave	Sistemi duhet të mundësojë administratorin të caktojë përdoruesve të drejtat bazuar në grupet e paracaktuara. Këto të drejta përfshijnë mundësinë e hedhjeve të të dhënave, analizën e të dhënave, exportin e të dhënave, gjenerimin e raporteve, etj.).
Log-et	Sistemi duhet ti mundësojë administratorit një ndërfaqe për të parë të gjitha loget e sistemit, bazuar në specifikimet e bëra në piken 4.1.4, pa lejuar modifikim e tyre. Sistemi duhet të lejojë exportin e log-eve në format tabelar për nevoja auditimi.
Format e raportimit	Sistemi duhet ti ofrojë mundësinë administratorit të krijojë, modifikojë ose të fshijë format e raportimit për operatorët në varësi të ndryshimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Moduli i Raportimit	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Format e raportimit	Sistemi duhet të lejojë operatorët të raportojnë indikatorët e përcaktuar në format digjital në sistem.
Eksporti i të dhënave	Sistemi duhet të mundësojë përdoruesin të eksportojë të dhënat e raportuara prej tij për arsye të ndryshme në format tabelar.
Cikli i raportimit	Sistemi duhet të mundësojë raportimin sipas rregulave në fuqi, përfshirë këtu afatet kohore të raportimit
Grafikët	Sistemi duhet ti mundësojë operatorit të analizojë të dhënat e tij dhe të ndërtojë grafikë sipas nevojës.
Menaxhimi i fjalë kalimeve	Sistemi duhet ti lejojë përdoruesit të ndryshojë fjalëkalimin e tij në çdo moment, brenda kërkesave të sigurisë të përcaktuar në këtë dokument ose gjatë fazës së analizës së projektit

Moduli i Analizës	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Kontrolli i raportimit	Sistemi duhet të mundësojë përdoruesit, punonjës të QPN-ve dhe Drejtorisë qendrore, të mund të identifikojnë dhe kontrollojnë operatorët që kanë raportuar dhe të dhënat e raportuara nga secili operator. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shenjojë ato forma që i ka kontrolluar.
Analiza / grafikët	Sistemi duhet ti mundësojë përdoruesve një ndërfaqe ku të mund të analizojnë të dhënat që janë raportuar nga të gjithë operatorët. Analiza përfshin krijimin e grafikëve të ndryshëm për çdo indikator dhe mundësinë e krahasimit të indikatorëve të ndryshëm me njeri-tjetrin.
Eksportimi i të dhënave	Sistemi duhet ti ofrojë përdoruesit një ndërfaqe për të filtruar dhe eksportuar të dhënat sipas nevojës. Këto të dhëna duhet të filtrohen në nivelet e mëposhtme: ○ Filtri 1 – Burimi

	○ Filtri 2 – Sektori ○ Filtri 3 – Grupi ○ Filtri 4 – Pusi ○ Filtri 5 – Intervali kohor
Gjenerimi i raporteve	Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin automatik të raporteve të specifikuara në pikën 13.2 si dhe të tjera që mund të përcaktohen në fazën e parë të projektit. Sistemi duhet të mundësojë eksportin e tyre në forma tabelare ose dokumenti. Në rast grafikësh, raporti duhet të eksportohet në formë imazhi.
Manaxhimi i fjalëkalimeve	Sistemi duhet ti lejojë përdoruesit të ndryshojë fjalëkalimin e tij në çdo moment, brenda kërkesave të sigurisë të përcaktuar në këtë dokument ose gjatë fazës së analizës së projektit.

Moduli i Dashboard-eve	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Dashboard	Sistemi duhet ti mundësojë nivelet drejtuese të kenë qasje në dashbord-e të para konfiguruara dhe përcaktuar në fazën e parë të projektit në funksion të një vendimarrje të shpejt dhe efikase. Këto të dhëna mund të filtrohen në afate kohore, për të ndihmuar vendimarrjen.

Operatori ekonomik fitues, gjatë fazës së parë të projektit, mund të sygjerojnë funksionalitete shtesë bazuar në informacionin që do merret nga takimet me përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. Këto funksionalitete shtesë do të listohen në raportin fillestar të cilin operatori ekonomik do të dërgoj në Albpetrol sh.a bazuar në afatet kohore të lart përmendura.

➤ Platforma Mobile (Aplikacioni Mobile)

Aplikacioni Mobil duhet të lejojë përdoruesit të aksesojnë platformën nga një aplikacion mobil, nga platformat Android dhe IOS, duke ofruar fleksibilitet dhe akses në kohë reale për operacionet në terren. Ky aplikacion është i nevojshëm për të lehtësuar raportimin e të dhënave dhe monitorimin, duke mundësuar përdoruesve të kryejnë detyrat e tyre në teren dhe në kohë reale

Funksionaliteti	Përshkrimi
Hyrja në sistem përmes aplikacionit	Aplikacioni mobil do të sigurojë akses të sigurt për përdoruesit e autorizuar përmes kredencialeve të personalizuara.
Raportimi në terren	Përdoruesit do të jenë në gjendje të raportojnë të dhënat direkt nga terreni përmes aplikacionit. Ky funksionalitet do të përfshijë format të përshtatura për përdorim mobil, duke lejuar futjen e të dhënave në kohë reale për pushtet, grupet dhe sektorët përkatës.
Monitorimi i të dhënave	Aplikacioni do të mundësojë monitorimin në kohë reale të prodhimit, duke i lejuar përdoruesve të shikojnë të dhënat e fundit mbi performancën e puseve dhe sektorëve, si dhe të

	ofroj grafikë të thjeshtë për të krahasuar indikatorët kryesorë të performancës.
Akresi në dashboard	Menaxherët dhe nivelet drejtuese do të kenë akses në dashbordet kryesore përmes aplikacionit mobil, duke mundësuar një monitorim të shpejtë dhe në kohë reale të operacioneve. Akresi do të jetë i optimizuar për vendimarrje të shpejta dhe efikase.
Njoftimet dhe alarmet	Përdoruesit do të marrin njoftime dhe alarme të menjëhershme në pajisjet e tyre mobile si dhe ato në desktop. Këto njoftime do të ndihmojnë në ndërhyrjen e shpejtë dhe adresimin e problemeve në terren.
Azhurnime dhe sinkronizim	Aplikacioni do të jetë në gjendje të sinkronizohet automatikisht me sistemin kryesor, duke garantuar që të gjitha të dhënat e futura nga pajisjet mobile të jenë të përditësuara dhe të disponueshme në platformë në kohë reale.
Përdorimi offline	Aplikacioni do të ketë funksionalitet për përdorim offline, ku përdoruesit mund të futin të dhëna edhe kur nuk kanë akses në internet. Pasi pajisja të lidhet me rrjetin, të dhënat do të sinkronizohen automatikisht me platformën kryesore.
Menaxhimi i fjalëkalimeve	Përdoruesit do të kenë mundësinë të ndryshojnë fjalëkalimet e tyre përmes aplikacionit mobil në çdo moment, duke respektuar kërkesat e sigurisë të përcaktuara për platformën dhe aplikacionin.

Operatori ekonomik fitues, gjatë fazës së parë të projektit, mund të sigjerojnë funksionalitete shtesë bazuar në informacioni që do merret nga takimet me përfaqësuesit të Albpetrol sh.a. Këto funksionalitete shtesë do të listohen në raportin fillestar të cilin operatori ekonomik do të dërgojë në Albpetrol sh.a bazuar në afatet kohore të lart përmendura

13.3. Raporte

Sistemi duhet të gjenerojë listën e mëposhtme të raporteve tabelare dhe grafike:

- Bilancin e prodhimit të naftës totale, sipas vendburimeve, sektorëve grupave ose puseve; ku do të gjenerohen afërsisht rreth 1300 raporte me të dhënat në kohë reale dhe progresive kalendarike në nivel granular duke filluar nga të dhënat e secilit pus, deri në hierarki me të larta deri në nivel Qendër Prodhimi dhe në total për të gjithë shoqërisë Albpetrol.
- Performancën e prodhimit në nivel pusi, grupi, sektori dhe vendburimi;
- Mbetjet e proceseve të dekantimit;
- Performancën e vendburimeve (Naftë Bruto kundrejt Fluidit të nxjerr)
- Etj raporte shtesë që mund të dalin përgjatë fazës së implementimit.

14.KËRKESAT TEKNIKE

Kërkesat teknike për platformën janë si mëposhtë:

Arkitektura	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Arkitekturë me shtresa	Sistemi duhet të ofrojë një arkitekturë shtresore, duke ndarë të dhënat, llogjikën e punës dhe shtresën e publikimit në mënyrë

	që të rritet siguria dhe fleksibiliteti i sistemit Shtresat minimale të sistemit duhet të jenë: ○ Shtresa e të dhënave ○ Shtresa e proceseve të punës ○ Shtresa e prezantimit
Ndërveprimi	Sistemi duhet të ofrojë API të standardizuar në mënyrë që të mundësojë ndërveprimin me sisteme të ndryshme në të ardhmen. API-t duhet të ngrihen bazuar në modelet më të mira të zhvillimit.
Baza e të dhënave	Sistemi duhet të ndërtohet bazuar në baza të dhënash relacionale. Kostot e licencimit duhet të jenë të përfshira në projekt ose platforma me kode burim të hapur.
Gjuha e programimit	Sistemi duhet të programohet në gjuhë që ofrojnë fleksibilitet dhe siguri të lartë. Platforma nuk duhet të ketë kosto licencimi, me qëllim funksionimin e saj. Gjithashtu, gjuhët duhet të lejojnë që platforma të mos varet nga sistemi i operimit por të mund të ekzekutohet në çdo OS.
Sistemi i operimit	Sistemi i operimit të serverit duhet të ketë arkitekturë 64 bit, të ofrojë Mirëmbajtje me Kohë të gjatë (<i>Long Term Support</i>) nga ("Furnizuesi"). Sistemi i operimit duhet të mos ketë kosto ekstra për përdorimin e tij dhe mos të ketë kohë mbarimi të licenses (perpetual licensing model)
Përputhshmëria	Sistemi duhet të aksesohet nga shfletuesit modernë si Google Chrome, Microsoft Edge, Mozilla Firefox etj. Aplikacioni mobil duhet të jetë i aksesueshëm nga pajisjet inteligjente me sistem operativ iOS dhe Android.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Ngritja e sistemit të raportimit për prodhimin e naftës bruto për shoqërinë Albpetrol sh.a”

Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Ndërtimi i sistemit të raportimit Design i bazës së të dhënave; Zhvillimi i backend-it të platformës; Zhvillimi i dashbord-eve të ndryshëm; Zhvillimi i ndërfaqes web të platformës;	Set	1		
2.	Ndërtimi i modulit të raportimit	Cope	1		
3.	Ndërtimi i aplikacionit mobile (IOS dhe Android)	Cope	2		
4.	Trajnimi i personelit për sistemin e ri (jo më shumë se 20 persona për klasë)	Klasa	5		
5.	Mirëmbajtje dhe support	Vite	3		
TOTALI PA TVSH (LEKË)					

Afatet e ekzekutimit: Ngritja e sistemit të raportimit për prodhimin e naftës bruto për shoqërinë Albpetrol sh.a për një periudhë 6 mujore dhe tre vjet mirëmbajtje.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

